

KLSH MERR PJESE AKTIVISHT NË GRUPET E PUNËS SË EUROSAT-t

*nga Irena ISLAM¹ – Drejtore Drejtorie, Amantja PATOZI –Audituese e Parë,
botuar në gazetën “Telegraf”, më 08 maj 2015.*



Në datat 20-21 prill 2015, u zhvillua në Romë, takimi i VI-të i grupit Task Force të EUROSAT-it për “Auditimin dhe Etikën” (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi dhe të interesit në rritje të institucionit për këtë çështje, KLSH mori pjesë në këtë aktivitet të rëndësishëm të EUROSAT-t, i cili trajtoi një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, Etikën, e cila është e lidhur direkt me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për Institucionet Supreme të Auditimit, të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

Në takim morën pjesë përfaqësuesit e 19-të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve): Gjykata Portugeze e Llogarive që kryeson *Task Forcën*, Shqipëria, Republika Çeke, Gjykata Evropiane e Audituesve, Kroacia, Maqedonia, Izraeli, Italia, Malta, Mali i Zi, Holanda, Polonia, Mbretëria e Bashkuar, Rumania, Rusia, Serbia, Spanja, Turqia dhe Hungaria.

Punimet e këtij takimi u hapën me një prezantim të dy audituesve të SAI-t italian (që ishte edhe SAI mikpritës) "***Etika dhe korrupsionit: dy anë të së njëjtës medalje***", të cilët theksuan rëndësinë e identifikimit të sjelljeve etike dhe veçanërisht të sjelljeve jo-etike, në mënyrë që këto të fundit të luftohen në mënyrën e duhur. Referuesit u përqendruan në diskutimin e tyre tek sjellja etike, e cila ngjall besim tek grupet e interesit dhe nga ana tjetër tek mungesa e etikës, e cila favorizon korrupsionin dhe sjell mungesë të theksuar besimi tek komuniteti.

Çështje të tjera të rëndësishme që u diskutuan në këtë takim ishin:

- Rritja e ndërgjegjësimit të SAI-ve për rëndësinë e etikës brenda SAI-ve (SAI Holandez dhe Portugez);
- Monitorimi i kuadrit ligjor dhe praktikave të sjelljes etike brenda SAI-ve (SAI Portugez);
- Rishikimi i shpërndarjes së informacionit në WEB-in e TFA&Ethics;
- Problemet etike/dyshimet/dilemat kryesore me të cilat audituesit përballen në punën e tyre të përditshme (Gjykata Evropiane e Audituesve, SAI i Italisë, Maqedonisë, Polonisë, etj);

- Konflikti i interesit dhe krijimi i kushteve për funksionimin e “Bilbil-fryrësit” brenda SAI-ve (SAI i Izraelit dhe Mbretërisë së Bashkuar).

Në ditën e dytë të takimit u diskutua rreth realizimit të objektivave të Planit të Veprimit të TFA&Ethics dhe këtu vlen të theksohet kontributi konkret i KLSH në objektivin e 2-të *“Forcimi i monitorimit dhe kontrollit të sistemeve të etikës në SAI”*.

KLSH solli eksperiencën konkrete duke theksuar arritjet e saj në këtë drejtim, duke u përqendruar **në bazën ligjore dhe rregullatore**: vendosja e një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit ka qenë në fokusin e strategjisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ligji i Ri i KLSH-së, rregullore të brendshme, urdhra apo udhëzime, përkthime të standardeve, publikime dhe mbi të gjitha përditësimi i Kodit të Etikës së Institucionit në përputhje me ndryshimet e ndodhura.

Aktivizimi dhe rritja e rolit të çdo audituesi në çështjet e Etikës. Një fakt interesant që tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve ishte iniciativa e Kryetarit të KLSH-së për të komunikuar drejtpërsëdrejti me çdo auditues që dëshiron të bisedojë dhe të diskutojë me Kryetarin për çështje që ata i gjykojnë të rëndësishme.

Ky komunikim u dha mundësinë audituesve të shkëmbenin opinione dhe të jepnin sugjerime për përmirësimin e punës në KLSH. Kjo u vlerësua si risi interesante dhe gjithëpërfshirëse, e cila u jep të gjithëve besimin që zëri i tyre mund të dëgjohet dhe që çdo njeri prej audituesve, nëse angazhohet dhe merr iniciativën të shprehet, mund të ndikojë në vendimmarrjen e institucionit.

U evidentua gjithashtu fakti që në Kontrollin e Lartë të Shtetit një kujdes i veçantë i është kushtuar trajnimit të stafit të rekrutuar rishtazi. Si pjesë e Programit dhe politikës së trajnimit në KLSH, të gjithë punonjësit menjëherë pas rekrutimit i nënshtrohen një sesioni specifik trajnimesh “Prezantim me KLSH dhe profesionin e audituesit publik”, i cili zgjat 2 javë. Gjatë kësaj periudhe, ata njihen me kuadrin e përgjithshëm ndërkombëtar dhe kombëtar të auditimit publik, Standardet dhe Ligjin për KLSH, ashtu dhe me çështje të veçanta teknike të profesionit të audituesit publik. Ndër temat e trajtuara, 20% e tyre lidhen me çështjet e Etikës.

Ngritja e strukturave adekuate të Etikës në KLSH. Në strukturën organizave të KLSH-së bën pjesë edhe Sektori i Etikës, në të cilin kryen funksionin “Inspektori i etikës”. Me shumë interes u ndoq nga pjesëmarrësit e takimit mënyra sesi është ngritur në KLSH “Komisioni i etikës”, në përbërje të të cilit janë tre anëtarë:

- 1 Inspektori i etikës dhe integritetit i cili ka statusin e nëpunësit civil.
- 2 Një auditues, me eksperiencë 26 vjeçare në KLSH dhe që është aktualisht në pension por që në kurrikulën e tij profesionale ka demonstruar profil të lartë të etikës dhe integritetit gjatë ushtrimit të detyrave të tij.
- 3 Një auditues i KLSH-së, i cili është votuar nga stafi i institucionit.

Kjo strukturë është përgjegjëse për hetimin e shkeljeve të etikës/integritetit nga ana e audituesve dhe e pjesës tjetër të stafit të KLSH-së. Indicie, ankesa dhe letra që vijnë në adresë të institucionit nga publiku verifikohen nga kjo

drejtori. Kjo ka qenë një masë me efekt parandalues për forcimin e sistemit të kontrollit të integritetit në KLSH.

Këto letër-ankesa të qytetarëve, janë administruar me profesionalizëm nga struktura e mësipërme dhe qytetarët marrin në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk janë kompetencë e KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë vitit 2014, 394 **letra dhe ankesa**, për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 **rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit**. Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 121 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 103 janë në procesin e verifikimit.

Promovimi i transparencës dhe rritja e komunikimit të SAI-ve me grupet e interesit, ishte një nga çështjet ku KLSH solli eksperiencën e saj të pasur në drejtim të:

Realizimit të projekte konkrete të bashkëpunimi me disa prej OJF-ve dhe organizatave të profesionistëve të fushës në Shqipëri në këto drejtime:

- “Realizimi i transparencës dhe komunikimit të KLSH-së me publikun dhe qytetarët” nga Lëvizja Evropiane, Shqipëri;
- “Analiza e impaktit të shkrimeve të Audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar”, nga botuesi i Gazetës “Ekonomia”;
- “Kontrolli i Cilësisë në të ftohtë” nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; dhe

- “Kontrolli i Procesit të Rekrutimit të stafit të KLSH-së”, nga Instituti “G&G Group”.

Të gjitha këto projekte janë parë si *Mini Peer Review (Rishikim mes kolegësh)* dhe kanë nxjerrë produkte konkrete, ku janë evidentuar përveç arritjeve dhe mangësitë e dobësitë. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do të shikohen me prioritet nga KLSH me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Transparenca e veprimtarisë së KLSH-së po rritet nga viti në vit dhe KLSH është gjithnjë e më e hapur dhe bashkëpunuese me median. Nga përfaqësuesit e KLSH në këtë takim u theksua fakti që në fund të vitit 2014, KLSH ka gjashtëfishuar praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median e shkruar dhe ka katërfishuar prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.

Një risi e padiskutueshme është edhe prezenca e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në shtypin e shkruar, të cilët nëpërmjet shkrimeve të tyre kanë bërë prezente për lexuesit problematikat e auditimeve në institucionet shtetërore, por edhe zhvillimet e institucionit, rritjen e kapaciteteve audituese të stafit nëpërmjet trajnimeve, etj. Gjatë vitit 2014, audituesit e KLSH-së ka qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetatat me 134 shkrime, të shkruara nga 51 auditues të KLSH-së, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve.

Në fund të takimit u vendos që takimi i ardhshëm i TFA&E të zhvillohet në Spanjë dhe që ky grup do të jete prezent me diskutime konkrete në *Young*

EUROSAI në Izrael dhe në Konferencën e Tetë të Përbashkët EUROSAI-OLACEFS që do të zhvillohet në Ekuador në qershor të këtij viti.

¹ Shkrime të tjera të botuara nga Irena ISLAMI për periudhën janar–qershor 2015:

- Roli i Institucioneve Supreme të auditimit në zhvillim e qëndrueshëm
(Botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 16 maj 2015.)